



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 korrik 2024
Nr. ref.: RK 2507/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI132/23

Parashtrues

Ruzhdi Behluli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I.-21-0331-A0001] të 1 qershorit 2023, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga Ruzhdi Behluli (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në fshatin Gjinoc, Komuna e Suharekës, i përfaqësuar nga avokati Shaip Ramadani, nga Komuna e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [AC-I.-21-0331-A0001], të 1 qershorit 2023, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit të DHPGJS-së) në lidhje me Aktgjykimin [C-IV-15-0545] të 7 majit 2021 të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar i DHPGJS).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I.-21-0331-A0001], të 1 qershorit 2023, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për atë sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 13 qershor 2023, parashtruesi i kërkesës përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 26 qershor 2023, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
8. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme DHPGJS), me kërkesë që paraqitja e komenteve eventuale të bëhet me shkrim brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të shkresës.
9. Më 27 qershor 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI132/23] caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe përmes vendimit [Nr. KSH. KI132/23] Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).

10. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
11. Më 16 korrik 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata në përbërje të plotë pas këshillimit, vendosi të deklarojë, me 7 (shtatë) vota për dhe 2 (dy) kundër, kërkesën të papranueshme.

Përmbledhje e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës kishte qenë i punësuar në NSH - KBI "Progres-Export", Drejtoria Lavërtari – Blegtori – DLB (në tekstin e mëtejme: NSH - KBI "Progres-Export"), Prizren si punëtor fizik, me pagë prej 165.32 € (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro e tridhjetë e dy cent).
13. Më 6 shtator 2013, Agjencia Kosovare të Privatizimit – Zyra Rajonale në Prizren (në tekstin e mëtejme: AKP - Prizren) përmes njoftimit Nr. 31/52, njoftoi parashtruesin e kërkesës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me NSH – KBI "Progres-Export", për shkak të shitjes së shitjes së Ndërmarrjes, përmes procesit të likuidimit të Ndërmarrjes, e cila është miratuar nga Bordi i AKP-së, ku përcaktohet se shitja e ndërmarrjes është e plotfuqishme nga data 3 qershor 2013, në ora 12:00.
14. Më 14 korrik 2014, Autoriteti i Likuidimit të AKP-së përmes njoftimit me numër protokoli Nr. 26971, njoftoi parashtruesin e kërkesës për fillimin e procesit të likuidimit të NSH – KBI "Progres-Export", që nga data 14 korrik 2014, me vendim të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Bordi i AKP-së).
15. Më 19 gusht 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për dëmshpërblim për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës, pranë Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, në vlerën e shtatë pagave mujore nga 165.32 € (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro e tridhjetë e dy cent) që në shumën e përgjithshme kap vlerën e 1.157.24 € (njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë euro e njëzet e katër cent), si dhe në të njëjtën kërkesë, kërkoi kompensim për pagat e papaguara për periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2013, në vlerën prej 11.771.34 € (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një euro e tridhjetë e katër cent) për kohën sa kishte punuar në NSH-KBI "Progres-Export" si punëtor fizik.
16. Nga shkresat e lëndës rezulton se në të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës paraqiti edhe një kërkesë për kompensim në vlerën e tri pagave mujore nga 165.32 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro e tridhjetë e dy cent) që në shumën e përgjithshme kap vlerën e 495.96 € (katërqind e nëntëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent), për periudhë të pacaktuar.
17. Më 23 mars 2015, Autoriteti i Likuidimit i AKP-së përmes Vendimit [PRZ009 - 0208] e refuzoi si të pavlefshme kërkesën e parashtruesit për dëmshpërblim për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës në shumën prej shtatë (7) pagave mujore nga 165.32 € (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro e tridhjetë e dy cent) që në shumën e përgjithshme kap vlerën e 1.157.24 € (njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë euro e njëzet e katër cent).
18. Më 30 mars 2015, Autoriteti i Likuidimit i AKP-së përmes Vendimit [PRZ 0009 - 0206] e refuzoi si të pavlefshme kërkesën e parashtruesit për kompensim në vlerën e tri pagave mujore nga 165.32 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro e tridhjetë e dy cent) që në

shumën e përgjithshme kap vlerën e 495.96 € (katërqind e nëntëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent), për periudhë të pacaktuar.

19. Më 3 prill 2015, Autoriteti i Likuidimit i AKP-së përmes Vendimi [PRZ0009 - 210] e refuzoi si të pavlefshme kërkesën e parashtruesit për kompensim të pagave të papaguara në shumën prej 11.771.34 € (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një euro e tridhjetë e katër cent), në emër të pagave të papaguara për periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2013.
20. Më 24 prill 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në DHPGJS kundër Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, përmes të cilës kërkoi që: (i) të aprovohet kërkesëpadija e tij; (ii) të shfuqizohet Vendimi [PRZ 0009-0206] i 30 marsit 2015, të Autoritetit të Likuidimit të ALP-së, ku ishte refuzuar kërkesa e tij për 3 (tri) pagat e papaguara në vlerën prej 495.96 € (katërqind e nëntëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent); si dhe të urdhërohet Autoriteti i Likuidimit të AKP që t'ia kompensojë pagat e papaguara parashtruesit të kërkesës për periudhën kohore 2004-2013 në shumën prej 12,267.30 € (dymbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë e tridhjetë euro), me kamatë ligjore në shkallën prej 10% (dhjetë përqind) duke filluar nga 1 janari 2014 e deri në pagesën definitive.
21. Më 2 prill 2021, Autoriteti i Likuidimit të AKP-së dorëzoi përgjigje në padinë e parashtruesit të kërkesës me propozim që ankesa të refuzohet dhe të vërtetohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit. Nga shkresat e lëndës rezulton se Autoriteti i Likuidimit të AKP-së në këtë përgjigje deklaroi se ndërmarrja shoqërore në fjalë ka hyrë në procedurën e likuidimit më 7 korrik 2014, ndërsa më 19 gusht 2014, ndërsa parashtruesi ka parashtruar kërkesë, përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e tri pagave të papaguara pa e specifikuar periudhën kohore. Tutje, Autoriteti i Likuidimit të AKP-së nënvizoi se me rastin e vendosjes në kërkesën e parashtruar kishte bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe saktë i ka zbatuar edhe dispozitat ligjore, respektivisht sqaroi se pika 1 e nën paragrafit 6 të paragrafit 1 të nenit 40 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për AKP-në) parashikon që tri pagat e pa paguara të punonjësve janë kërkesa prioritare dhe se kanë prioritet të lartë, mirëpo kjo dispozitë nuk i bënë të gjithë punëtorët me të drejtë për tri paga por iu jep prioritet tri pagave të fundit që eventualisht kanë mbetur pa paguar, dhe se në çdo rast, mbi bazën e nën paragrafit 2 të paragrafit 1 të nenit 36 të po kësaj shtojce të ligjit, kërkesa për paga të pa paguara duhet të mbështetet me dëshmi përkatëse, andaj pas kryerjes së vlerësimit të kërkesës në fjalë, e ka gjetur atë si të pavlefshme. Po ashtu në përgjigjen e parashtruar, ajo theksoi se kërkesa e parashtruesit ishte e parashkuar, ngase ka të bëjë me kërkesë të vitit 2004, dhe që nga ajo kohë e njëjta nuk kishte prezantuar prova se i është drejtuar gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent në lidhje me pagat e papaguara.
22. Më 7 maj 2021, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së përmes Aktgjykimit [C-IV-15-0545] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Vendimit [PRZ009-0206] të 30 marsit 2015, të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së.
23. DHPGJS në aktgjykimin e saj fillimisht vendosi që të mos mbajë seancë dëgjimore në këtë çështje bazuar në paragrafin 3 të nenit 76 (Konfliktet dhe interpretimi) të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm; Ligji për DHPGJS për Çështjet në lidhje me AKP-në) në lidhje me nenin 399 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK) sepse vlerësoi se *“Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se ankesa është e pa bazuar”*

24. Në lidhje me Vendimin [PRZ009-206], të 30 marsit 2015 të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së arsyetoi si në vijim:

“[...] Pala paditëse pranë Autoritetit të Likuidimit ka parashtruar kërkesë për kompensim të tri pagave për periudhën e pa caktuar, po ashtu pala paditëse ka parashtruar edhe një kërkesë për kompensimin e 7 pagave si dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës.

Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësimin e kërkesave të parashtruara dhe me vendimet PRZ009-0206 dhe PRZ009-0208, kërkesat e parashtruara nga pala paditëse në procedurën e likuidimit i ka refuzuar si të pa bazuara.

Pala paditëse me padi ka pretenduar në borxh- për shkak të mos pagesës së pagave e që i referohet periudhës kohore nga viti 2004 e deri në vitin 2013. Në anën tjetër pala e paditur në mbrojtjen [përgjigjen në padi] e dhënë ka pretenduar se kërkesa e pretenduar e palës paditëse është e parashkruar ngase nuk ka prezantuar prova që i është drejtuar gjykatës apo ndonjë organi kompetent mer kërkesë për kompensimin e pagave të pretenduara që nga viti 2004. Me nenin 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978) në mënyrë shprehimore është e përcaktuar se “kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin”. Në rastin konkret borxhi i pretenduar nga pala paditëse i përket periudhës nga viti 2004 e deri në vitin 2013, dhe në kuptim të dispozitës ligjore të cituar rezulton se kërkesa e palës paditëse është e parashkruar”.

25. Më 9 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë kundër Aktgjykimit [C-IV-15-0545] të 7 majit 2021 të DHPGJS-së për shkak të: (i) shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) konstatimit të gabuar të gjendjes faktike; dhe (iii) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJ-së që të aprovojë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar i DHPGJS- së dhe t'i njihet e drejta e kompensimit të pagave të papaguara prej 31 dhjetorit 2004 deri më 31 gusht 2013 në shumën prej 12.267.13 € (dymbëdhjetë mijë e dyqind gjashtëdhjetë e shtatë e trembëdhjetë euro), si dhe dëmshpërblimin për ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënies së punës në shumën prej 1,157.24 € (njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë euro e njëzet e katër cent).
26. Parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij po ashtu theksoi se Aktgjykimi i ankimuar nuk përmbante asgjë lidhur me faktet vendimtare për rastin, i cili ishte objekt i aktgjykimit. Sipas tij, Kolegji i Specializuar i DHPGJS nuk i kishte vlerësuar provat në shkresat e lëndës, si dhe nuk kishte bërë shqyrtimin e gjithanshëm të padisë së paditësit. Rrjedhimisht sipas parashtruesit, për shkak të metave që aktgjykimi i kishte, arsyetimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së ishte haptazi jologjik dhe i pakuptueshëm. Tutje, ai në ankesën e tij ndër të tjera, theksoi se Autoriteti i Likuidimit të AKP-së, në të gjitha rastet e refuzimit të kërkesave të tij thirrej në parashkrimin në kuptim të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar (në tekstin e mëtejme: LPB), mirëpo Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nuk e ka marr parasysh fare dhe as nuk e ka përmendur në arsyetimin e aktgjykimit se përmbushja e detyrimeve ndaj punëtorëve të cilët kanë qenë në punë deri në kohën e fillimit të privatizimit të ndërmarrjes publike është e rregulluar me ligj special, respektivisht Ligjin për AKP-në, prandaj neni 608 i LPB-së nuk mund të zbatohet.
27. Më 7 tetor 2021, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur parashtrësë për plotësimin e ankesës se parashtruar kundër Aktgjykimit [C-IV-15-0545] të 7 majit 2021, të cilës parashtrësë ia bashkëngjiti Vendimin [PRZ009-0210] të 3 prillit 2015 të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së dhe formularin për parashtrimin e kërkesës jo-pronësore në likuidim. Ai në këtë parashtrësë theksoi po ashtu se: “AKP, me datë 02.4.2021, ka

parashtruar mbrojtje [përgjigje në padi] në gjykatë, ndaj padisë së paditësit [R.B], nga Prizreni, mirëpo mbrojtja e AKP nuk iu është dorëzuar paditësit, për të dhënë përgjigje në të”.

28. Më 1 qershor 2023, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së përmes Aktgjykimit [AC-I-21-0331-A0001] vendosi që: **(i)** ankesa e parashtruesit të kërkesës është e bazuar; **(ii)** të ndryshohet Aktgjykimi [C-IV.-15-0561] i 7 majit 2021 i DHPGJS-së dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit me [PRZ009-206] i 30 marsit 2013 dhe **(iii)** obligohet e paditura që në emër të tre pagave të papaguara t’ia paguajë paditësit shumën prej 495.96 € (katërqind e nëntëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent), sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit si dhe **(iv)** nuk caktoi taksa gjyqësore për procedurën ankimore.
29. Kolegji i Apelit të DHPGJS-së në aktgjykimin e saj fillimisht vendosi që të mos mbajë pjesën gojore të procedurë bazuar në paragrafin 1 të nenit 69 të Ligjit për DHPGJS për Çështjet në lidhje me AKP-në.
30. Lidhur me ankesën e parashtruesit të kërkesës, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së arsyetoi se:

*[...] Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për tre paga të papaguara në shumën prej 495.96 euro me vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRZ009-0206 të datës 30 mars 2015 ishte refuzuar si e pavlefshme me arsyetimin se paditësi nuk rezultoi të ketë ofruar shërbime për N.SH dhe sepse AL kishte vlerësuar që në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar kërkesa e paditësit ishte parashkuar.
[...]*

*Kolegji i Apelit i DHPGJS-së vlerëson se Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së nuk është vendim i drejtë. Kjo për faktin se paditësi fillimisht kishte dorëzuar një ankesë në DHPGJS me datë 24 prill 2015 me të cilën kishte ankimuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ009-0206 të datës 30 mars 2015 i cili trajtonte kompensimin për tre paga të papaguara në shumën prej 495.96 euro (3*165.32) dhe jo shumën që ai e kërkonte me ankesë prej 12,267.30 euro për periudhën nga viti 2004 deri në 2013.
[...]*

*Kolegji i Apelit konsideron se në rastin konkret shkalla e parë e DHPGJS-së duhet të kishte parasysh faktin se paditësi kishte ankimuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ009-0206 të datës 30 mars 2015 për tre paga të papaguara në shumën prej 495.96 euro dhe jo vendimin me nr. PRZ009-0208 të datës 23 prill 2015 si dhe PRZ09-0210 që paditësi nuk i kishte ankimuar, por vetëm bashkëngjitur në shkresë të lëndës në shkallën e parë të DHPGJS-së si dhe pranë Kolegjit të Apelit.
[...]*

Gjithashtu, Kolegji i Apelit vëren se nga kopja e librezës së punës shihet qartë që paditësit i është mbyllur librezë e punës me datë 6 shtator 2013, pikërisht me datën e fillimit të procesit të privatizimit N.SH-së, gjë që dëshmon se paditësi jo vetëm që ka ofruar shërbime për N.SH. por edhe marrëdhënia e punës i është ndërprerë si rezultat i veprimt/vendimit të AKP.

*Në këtë rast duke u bazuar në provat e lartcekura të cilat janë relevante për Kolegjin e Apelit, Kolegji i Apelit vendosi të ndryshoj Aktgjykimin e shkallës së parë të DHPGJS-së duke aprovuar paditësit kërkesës për kompensimin e tre pagave të papaguara në shumën prej 495.96 euro, e cila duhet të paguhet nga Autoriteti i Likuidimit sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e Likuidimit. Gjithashtu Kolegji i Apelit aprovon lartësinë e shumës së kërkuar edhe për arsye se e paditura nuk e kontestoi lartësinë e shumës së kërkuar.
Faktet e pakontestuar sipas nenit 7 të LPK-së konsiderohen të vërtetuara.*

Prandaj për këto arsye, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa e paditësit duhet të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
32. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Kolegjit i Specializuar i DHPGJS-së nuk lëshoi urdhër për rregullimin dhe plotësimin e padisë duke shkelur kështu dispozitat procedurale të Ligjit për DHPGJS për Çështjet në lidhje me AKP-në.
33. Ai në esencë pretendon gjithashtu se Kolegjit i Specializuar i DHPGJS-së kishte shkelur parimin e barazisë së armëve kur nuk ia dërgoi atij përgjigjen në padi të palës kundërshtare, respektivisht Autoritetit të Likuidimit të AKP-së të 2 prillit 2021, për të dhënë kundërpërgjigje siç, sipas tij, është e paraparë me Ligjin për DHPGJS për Çështjet në lidhje me AKP-në.
34. Parashtruesi i kërkesës po ashtu thekson se DHPGJS nuk caktoi seancë dëgjimore në rastin e tij duke nënvizuar se: “[...] Kolegji i Apelit i DHGJPS-së pa dhënë arsyetim për heqjen dore nga caktimi i seancës dëgjimore, e ndryshoi vendimin e Kolegjit të Specializuar dhe e obligoi të paditurën me detyrimin monetar, të cilin paditësi nuk e ka kërkuar (tri paga të fundit të mbetura pa u paguar).”

Dispozitat relevante Kushtetuese dhe Ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga

gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

LIGJI Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 6

(Fushëveprimi i kompetencave administrative të Agjencisë)

“1. Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2. Ky autoritet përfshinë çdo veprim që agjencia e konsideron të arsyeshëm dhe të duhur, brenda kufijve të burimeve administrative të Agjencisë, për të mundësuar më mirë shitjen, likuidimin, transferimin apo ndonjë zgjidhje tjetër të ndërmarrjes, asetit apo interesit në pronësi shtetërore. Pa paragjykim ndaj përgjithësimin në fjalinë e mëparshme, parashihet në mënyrë specifike që sa i përket ndërmarrjeve, ai autoritet të përfshijë të gjitha veprimet të cilat Agjencia i konsideron të arsyeshme dhe të duhura për ruajtjen ose rritjen e vlerës, shanseve për sukses ose qeverisjes së ndërmarrjes.

”

SHTOJCA E LIGJIT Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 37

(Llogaritja dhe kompensimi i kërkesave)

“7. Kreditori i prekur ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit nga ana e Autoritetit të Likuidimit që të vendos për kërkesën e tij dhe moskërkimi i tillë në kohë nga ana e kreditorit do ta pamundësojë atë në kundërshtimi i mëtejme i vendimit të Autoritetit të Likuidimit.

8. Gjykata nxjerr vendim lidhur me kërkesën e parashtruar nga kreditori i prekur jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë, pas datës në të cilën kërkesa është dorëzuar në Gjykatë dhe pasi një kopje e saj t’i jetë dorëzuar Autoritetit të Likuidimit, Komitetit të Kreditorëve (nëse ekziston) dhe palëve të tjera sipas udhëzimit të Gjykatës.”

Neni 40

(Prioritetet e kërkesave dhe interesave)

“1. Në procedurat e likuidimit të gjitha Kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim:

[...]

1.6.kërkesat preferenciale të punonjësve në renditjen si në vijim:

1.6.1.kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person;

1.6.2.kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në.

[...]

**LIGJI NR. 06/L-086 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS
SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË
KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

**Neni 9
(Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Ankesat)**

[...]

4. Çdo Aktgjykim dhe aktvendim nxirret me shkrim, si dhe:

[...]

4.2. përmban një prezantim të gjitha gjetjet faktike që kanë rëndësi materiale për rastin apo lëndën që është objekt i atij aktgjykimi apo aktvendimi;

4.3. ofron një shpjegim të qartë dhe të hollësishëm të bazës ligjore dhe arsytimit të përdorur në arritjen e atij aktgjykimi apo aktvendimi;

[...]"

**Neni 38
(Përgjigja e paditësit dhe kundërpërgjigja e të paditurit)**

"1. Përjashtimisht, nëse konstaton se padia apo përgjigja në padi është jo e plotë apo nevojiten sqarime shtesë, me qëllim të heqjes së mangësive të tilla, Gjyqtari i vetëm apo Kryesuesi i Kolegjit të themeluar në përputhje me nenin 4 paragrafi 9 i këtij ligji lëshon Urdhër duke i kërkuar paditësit që brenda shtatë (7) ditësh të paraqesë përgjigjen e tij ndaj përgjigjes në padi në fjalë.

2. Pas dorëzimit të përgjigjes nga paditësi, i padituri ka shtatë (7) ditë afat kohor për të paraqitur kundërpërgjigjen e tij ndaj përgjigjes.

3. Të njëjtat rregulla si në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni do të zbatohen mutatis mutandis edhe në procedure të ankesës para Kolegjit të Apelit."

**Neni 76
(Konfliktet dhe interpretimi)**

3. Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

**Neni 69
(Procedurat e ankesës me gojë)**

1. Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

**Neni 399
(Pa titull)**

"399.1 Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija.

399.2 Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.”

LIGJI MBI MARËDHËNIET E DETYRIMEVE (i aprovuar nga Kuvendi i ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, në seancën e Dhomës Federative më 30 mars 1978)

**Neni 376
(Pa titull)**

“Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin. Sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi. Kërkesa e shpërblimit të dëmit të krijuar nga cenimi i detyrimit kontraktues parashkruhet për kohën e caktuar për parashkrimin e këtij detyrimi.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
36. Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

37. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 (Kërkesa individuale) 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që parashikojnë:

**Neni 47
(Kërkesa individuale)**

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

38. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës: (i) është palë e autorizuar; (ii) konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC-I.-21-0331-A0001], e 1 qershorit 2023, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së në lidhje me Aktgjykimin [C-IV-15-0545] të 7 majit 2021 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së; (iii) ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; (iv) ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj; si dhe (v) e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
39. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, pika d e paragrafit 1 dhe paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcaktojnë që:
- “(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
[...]
(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.
[...]
(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.*
40. Gjykata fillimisht thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GJEDNJ-së [Kemachev kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykim i 24 nëntorit 1994, paragrafi 44, [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005, paragrafi 55; [Mentzen kundër Letonia](#), nr. 71074/01, vendimi

i 7 dhjetorit 2004, [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008, dhe rastet e Gjykatës [K104/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 prillit 2021, paragrafi 26; [K1107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021, paragrafi 53; dhe [K105/23](#) parashtrues *Branislav Gajin*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 janarit 2024, paragrafi 51).

41. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit si dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
42. Gjykata vëren se esenca e këtij rasti ndërlidhet me ankesën e parashtruesit të kërkesës pranë Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, ku kishte kërkuar (i) dëshmipërblim për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës; (ii) kompensim të pagave të papaguara për periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2013, si dhe (iii) kompensim në vlerën e 3 (tri) pagave mujore për periudhë të pacaktuar. Më 23, 30 mars dhe 3 prill të vitit 2015, Autoriteti i Likuidimit të AKP-së përmes tri vendimeve të veçanta refuzoi të tria kërkesat e parashtruesit të kërkesës. Më 24 prill 2015, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në DHPGJS kundër Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, përmes të cilës kërkoi që: (i) të aprovohet kërkesëpadija e tij; (ii) të ndryshohet Vendimi [PRZ 0009-0206], i 30 marsit 2015 i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, përmes të cilit ishte refuzuar kërkesa e tij; si dhe (iii) të urdhërohet Autoriteti i Likuidimit të AKP që t'ia kompensojë pagat e papaguara parashtruesit të kërkesës për periudhën kohore 2004-2013. Pastaj, më 2 prill 2021, Autoriteti i Likuidimit të AKP-së dorëzoi përgjigje në padinë e parashtruesit të kërkesës me propozim që padia të refuzohet. Tutje, më 7 maj 2021, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së përmes Aktgjykimit [C-IV-15-0545] refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës, aktgjykim i cili sipas ankesës së tij u prish nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së, më 1 qershor 2023 përmes Aktgjykimit [AC-I-21-0331-A0001], dhe e obligoi Autoritetin e Likuidimit të AKP-së që parashtruesit të kërkesës, t'ia paguajë shumën prej 495.96 € (katërqind e nëntëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent) në emër të tre pagave të papaguara. Në të dyja instancat, DHPGJS nuk kishte mbajtur seancë dëgjimore, për të cilën ofroi arsyetim në aktgjykimet përkatëse.
43. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon shkeljen e parimit të barazisë së armëve, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, kur nuk ia dërgoi atij përgjigjen në padi të palës kundërshtare, respektivisht Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, për të dhënë kundërpërgjigje, gjë që sipas tij, ishte e paraparë me Ligjin për DHPGJS për Çështjet në lidhje me AKP-në. Në kuadër të garancive procedurale të garantuara me këtë nen, parashtruesi i kërkesës po ashtu shprehimisht ngrit pretendime për mos mbajtjen e seancës dëgjimore, në lidhje me këtë thekson se: "*Kolegji i Apelit i DHPGJS-së pa dhënë arsyetim për heqjen dore nga caktimi i seancës dëgjimore, e ndryshoi vendimin e Kolegjit të Specializuar dhe e obligoi të paditurën me detyrimin monetar, të cilin paditësi nuk e ka kërkuar (tri paga të fundit të mbetura pa u paguar).*" Ai po ashtu, në kërkesën e tij, thekson se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nuk lëshoi urdhër për rregullimin dhe plotësimin e padisë duke shkelur kështu dispozitat procedurale të Ligjit për DHPGJS për Çështjet në lidhje me AKP-në.
44. Nga sa më sipër, duke marrë parasysh natyrën e kësaj kërkesë dhe pretendimeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata do të vlerësojë fillimisht pretendimet e

parashtruesit të kërkesës lidhur (i) me shkeljen e parimit të barazisë së armëve, si dhe më pas me (ii) mos mbajtjen e seancës dëgjimore.

(i) *Përkitazi me shkeljen e parimit të barazisë së armëve*

45. Përkitazi me barazinë e armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural, parime këto të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë gjyqësore, e cila është ndërtuar duke u bazuar në parimet e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Yvon kundër Francës*, nr. 44962/98, Aktgjykim i 24 korrikut 2003; *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, nr. 14448/88, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993; *Brandstetter kundër Austrisë*, nr. 11170/84, 2876/87; 13468/87, Aktgjykim i 29 gushtit 1991; *Vermeulen kundër Belgjikës*, nr. 19075/91, Aktgjykim i 20 shkurtit 1996; *Rowe and Davis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 18990/91; Aktgjykimi i 16 shkurtit 2000, *Jasper kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27052/95, Aktgjykimi i 16 shkurtit 2000; *Zahirović kundër Kroacisë*, nr. 58590/11, Aktgjykimi i 25 korrikut 2013; *Beer kundër Austrisë*, nr. 30428/96, Aktgjykim i 6 shkurtit 2001). Thënë këtë, rastet e Gjykatës përmes të cilave Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GJENDJ dhe të njëjtat i ka aplikuar edhe në rastet për shqyrtim para saj, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *KI108/10*, parashtrues *Fadil Selmanaj*, Aktgjykim i 5 dhjetorit 2011; *KI52/12*, parashtrues *Adije Iliri*, Aktgjykim i 5 korrikut 2013, *KI200/13*, parashtrues *Belkize Kallaq*, Aktgjykim i 15 prillit 2014; *KI10/14*, parashtrues, *Shoqëria aksionare Raiffeisen Bank Kosovë SH. A.*, Aktgjykim i 20 majit 2014; *KI31/17*, parashtrues *Shefqet Berisha*, Aktgjykim i 30 majit 2017; *KI47/17*, parashtrues *Selvet Aliji*, Aktgjykim i 28 dhjetorit 2018; *KI209/19*, parashtrues *Memli Krasniqi*, Aktgjykim i 26 nëntorit 2020; *KI82/21*, parashtruese *Komuna e Gjakovës*, Aktgjykim i 30 shtatorit 2021; *KI84/21*, parashtrues *Telekomi i Kosovës Sh.A*, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2021; *KI67/22*, parashtrues *Zeqirja Prebreza*, Aktgjykim i 4 prillit 2023, *KI206/21*, parashtrues *Ukë Salih*, Aktgjykim i 25 korrikut 2023, *KI122/21*, parashtrues *Lekë Bytyqi*, Aktgjykim i 27 korrikut 2021).
46. Gjykata vë në pah se, sipas praktikës gjyqësore të lartcekur, neni 6 i KEDNJ-së i detyron gjykatat që të bëjnë shqyrtim të mirëfilltë të parashtrësve, të argumenteve dhe të provave të paraqitura nga palët dhe të vlerësojnë, pa paragjykim, nëse ato janë të rëndësishme dhe me peshë për vendimin e saj (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ, *Kraska kundër Zvicrës*, nr. 13942/88, Aktgjykimi i 19 prillit 1993, paragrafi 30).
47. Një detyrim i tillë për gjykatat jetësohet, ndër të tjera, përmes zbatimit të parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në këtë kuadër, GJEDNJ ka nënvizuar se parimi i barazisë së armëve është element i qenësishëm i konceptit më të gjerë të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm dhe është ngushtësisht i lidhur me parimin e kontradiktoritetit procedural (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Regner kundër Republikës Çeke*, nr. 35289/11, Aktgjykim i 19 shtatorit 2017, paragrafi 146). Për më tepër, kërkesa e “barazisë së armëve”, në kuptimin e një “ekuilibri të drejtë” midis palëve, vlen në parim për raste civile si dhe për raste penale (shih rastet e Gjykatës *KI10/14*, parashtrues, *Shoqëria aksionare Raiffeisen Bank Kosovë SH. A.*, cituar më lart, paragrafi 42; dhe rastin *KI31/17*, cituar më lart, paragrafi 71, dhe po ashtu, shih rastin e GJEDNJ-së, *Werner kundër Austrisë*, nr. 138/1996/757/956, Aktgjykim i 24 nëntorit 1997, paragrafi 66).
48. Në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të cilën e ka ndjekur me konsistencë edhe Gjykata Kushtetuese, është theksuar në vazhdimësi se parimi i barazisë së armëve kërkon “ekuilibër të drejtë midis palëve”, ku secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme të paraqesë rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në pozitë të pafavorshme, gjegjësisht disavantazh thelbësor kundruall palës kundërshtare (shih

rastet e GJEDNJ-së, [Yvon kundër Francës](#), nr. 44962/98, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31 dhe [Dombo Beheer B.V. kundër Holandës](#), nr. 14448/88, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993, paragrafi 33, [Feldbrugge kundër Holandës](#), Aktgjykim i 7 korrikut 1987, paragrafi 44, rastet Ofrer dhe Hopfinger kundër Austrisë, nr 524/59 dhe 617/59, 19.12.60, Vjetari 6, f. 680 dhe 696, shih dhe referencat tjera në këtë Aktgjykim, [Öcalan kundër Turqisë](#) [DHM], nr. 46221/99, Aktgjykim i 12 majit 2005, paragrafi 140; shih po ashtu rastet e Gjykatës, [KI52/12](#), parashtrues *Adije Iliri*, Aktgjykim i 5 korrikut 2013, [KI103/10](#), parashtrues *Shaban Mustafa*, Aktgjykim i 20 marsit 2012, paragrafi 40, [KI193/19](#), parashtrues *Salih Mekaj*, Aktgjykim i 31 dhjetorit 2020, paragrafi 44).

49. Duke u mbështetur në praktikën e GJEDNJ-së, Gjykata ka nxjerrë Aktgjykimet në rastet e cituara më lart, KI67/22, me parashtrues *Zeqirja Prebreza*, KI206/21 dhe parashtrues *Ukë Salih*, dhe KI122/21, parashtrues *Lekë Bytyqi*, e ku e ajo kishte gjetur shkelje të parimit të barazisë së armëve në procedurë civile për shkak se Gjykata e Apelit nuk kishte shqyrtuar përgjigjen në ankesë të parashtruesve të kërkesave respektive, të cilat i kishin dorëzuar brenda afatit, dhe rrjedhimisht konsideroi se parashtruesit e kërkesave respektive u vunë në një pozitë dukshëm më pak të favorshme në krahasim me palën e kundërt, dhe si rrjedhojë iu ishte hequr mundësia për t'u përballur realisht dhe në mënyrë thelbësore me argumentet dhe pretendimet e bëra nga pala e kundërt.
50. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se ky parim ishte shkelur kur Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, gjatë procedurës së shqyrtimit të lëndës së tij, nuk ia dërgoi parashtruesit përgjigjen në padi të palës kundërshtare, respektivisht të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së të 2 prillit 2021, për të dhënë kundërpërgjigje siç është e paraparë me Ligjin për DHPGJS për Çështjet në lidhje me AKP-së, por ai në këtë rast nuk specifikon se cilat dispozita të këtij ligji janë shkelur në rastin konkret. Këtë pretendim, i njëjti e ka ngritur edhe para Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, me rastin e ankimimit të aktgjykimit të shkallës së parë.
51. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet përmbajtjes së paragrafëve 1 të neneve 37 (Përgjigja në ankesë) dhe nenit 38 (Përgjigja e paditësit dhe kundërpërgjigja e të paditurit) të Ligjit për DHPGJS për Çështjet në lidhje me AKP-në, të cilat nene rregullojnë procedurën e dhënies së përgjigjeve dhe kundërpërgjigjes së të paditurit në procedurën para DHPGJS-së. Më konkretisht, paragrafi 1 i nenit 37 të këtij ligji përcakton se: *“I padituri mund të paraqes Përgjigjen në padi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pasi t’i jetë dorëzuar kërkesa/ankesa.[...]”*, ndërsa, paragrafi 1 i nenit 38 të tij, parasheh se: *“1. Përrjashtimisht, nëse konstaton se padia apo përgjigja në padi është jo e plotë apo nevojiten sqarime shtesë, me qëllim të heqjes së mangësive të tilla, Gjyqtari i vetëm apo Kryesuesi i Kolegjit të themeluar në përputhje me nenin 4 paragrafi 9 i këtij ligji lëshon Urdhër duke i kërkuar paditësit që brenda shtatë (7) ditësh të paraqesë përgjigjen e tij ndaj përgjigjes në padi në fjalë. [...]”*
52. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës e parashtrori kërkesëpadinë e tij më 24 prill 2015, ndërsa më 2 prill 2021, Autoriteti i Likuidimit të AKP-së dorëzoi përgjigje në padinë e parashtruesit të kërkesës, e cila përcaktohet në paragrafin 1 të nenit 37 të Ligjit për DHPGJS për Çështjet në lidhje me AKP-në.
53. Gjykata vëren se paragrafi 1 i nenit 38 të Ligjit për DHPGJS për Çështjet në lidhje me AKP-në, nuk kërkon domosdoshmërisht që paditësit, në këtë rast parashtruesit të kërkesës, t’i dërgohet përgjigja në padi e palës kundërshtare në mënyrë që ai të kundërpërgjigjet. Konkretisht, dispozita në fjalë përjashtimisht parasheh dërgimin te parashtruesi i kërkesës për kundërpërgjigje, vetëm në rastet kur përgjigja në padi është *“jo e plotë”* apo *“nevojiten sqarime shtesë”*. Për pasojë, mbetet në diskrecionin e DHPGJS-së që të vlerësojë nëse përmbushen kërkesat ligjore që përjashtimisht t’i

dërgohet paditësit, respektivisht, parashtruesit të kërkesës, përgjigja në padi, për të dhënë kundërpërgjigjen respektive.

54. Thënë këtë, Gjykata konkludon se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të parimit të barazisë së armëve është i papranueshëm si qartazi i pabazuara në baza kushtetuese në “*mungesë evidente të shkeljes*” ashtu siç është përcaktuar me rregullin 34 (2) të Rregullores së Punës.

(ii) *Përkitazi me pretendimin për mos mbajtjen e seancës dëgjimore*

55. Gjykata vlerëson se nëse një gjykim i plotëson kriteret e publicitetit, është e nevojshme për të vlerësuar procedurat si tërësi (shih rastin e GJEDNJ-së [Axen kundër Gjermanisë](#), nr. 8273/78, Aktgjykim i 8 dhjetorit 1983, paragrafi 27). Karakteri i veçantë i rrethanave që mund të justifikojnë mos mbajtjen e seancës dëgjimore në thelb ka të bëjë me natyrën e çështjeve që duhet t'i vendos një gjykatë e rregullt dhe jo shpeshësia e situatave të tilla (shih rastet e GJEDNJ-së, [Miller kundër Suedisë](#), nr. 55853/00, Aktgjykim i 8 shkurtit 2005, paragrafi 29 dhe rastet e Gjykatës KI80/23, parashtrues *Behgjet Stoliqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2024, paragrafi 45 dhe [KI125/23](#), parashtrues *Hazir Publica*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 31 janarit 2024, paragrafi 44).
56. Mbajtja e seancës dëgjimore mund të mos kërkohet në rastet kur nuk ngritin çështje të besueshmërisë apo të fakteve të kontestuara që e bëjnë të nevojshme seancën dëgjimore ndërsa gjykatat e rregullta në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme mund ta vendosin zgjidhin rastin bazuar në parashtrës të dorëzuara nga palët dhe materialet tjera me shkrim (shih rastin e GJEDNJ-së [Saccoccia kundër Austrisë](#), nr. 69917/01, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008, paragrafi 73 dhe rastet e Gjykatës KI80/23, parashtrues *Behgjet Stoliqi*, cituar më lart, paragrafi 46 dhe KI125/23, parashtrues *Hazir Publica*, cituar më lart, paragrafi 45).
57. Gjykata po ashtu vëren se GJEDNJ-ja po ashtu ka pranuar se mos mbajtja e seancës dëgjimore mund të justifikohet në rastet që thjeshtë ngritin çështje ligjore të natyrës së kufizuar (shih rastin e GJEDNJ-së, [Allan Jacobsson kundër Suedisë](#) (nr. 2), nr. 8/1997/792/993, Aktgjykim i 18 shkurtit 1998, paragrafi 49;) apo të cilat nuk kanë ndonjë ndërlkueshmëri të posaçme (shih rastin e GJEDNJ-së, [Speil kundër Austrisë](#), nr. 42057/98, Vendim mbi pranueshmëri i 5 shtatorit 2002 dhe rastin e Gjykatës KI80/23, parashtrues *Behgjet Stoliqi*, cituar më lart, paragrafi 47 dhe KI125/23, parashtrues *Hazir Publica*, cituar më lart, paragrafi 46).
58. Në këtë drejtim, Gjykata vë në pah arsyetimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së:

“[...] Pala paditëse pranë Autoritetit të Likuidimit ka parashtruar kërkesë për kompensim të tri pagave për periudhën e pa caktuar, po ashtu pala paditëse ka parashtruar edhe një kërkesë për kompensimin e 7 pagave si dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës.

Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësimin e kërkesave të parashtruara dhe me vendimet PRZ009-0206 dhe PRZ009-0208, kërkesat e parashtruara nga pala paditëse në procedurën e likuidimit i ka refuzuar si të pa bazuara.

Pala paditëse me padi ka pretenduar në borxh- për shkak të mos pagesës së pagave e që i referohet periudhës kohore nga viti 2004 e deri në vitin 2013. Në anën tjetër pala e paditur në mbrojtjen [përgjigjen në padi] e dhënë ka pretenduar se kërkesa e pretenduar e palës paditëse është e parashkruar ngase nuk ka prezantuar prova që i është drejtuar gjykatës apo ndonjë organi kompetent mer kërkesë për kompensimin e pagave të pretenduara që nga viti 2004. Me nenin 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978) në mënyrë shprehimore është e përcaktuar se “kërkesa e

shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin”. Në rastin konkret borxhi i pretenduar nga pala paditëse i përket periudhës nga viti 2004 e deri në vitin 2013, dhe në kuptim të dispozitës ligjore të cituar rezulton se kërkesa e palës paditëse është e parashkruar

Përfundimisht gjykata ka ardhur në përfundimin se në rastin konkret i padituri drejtë ka vepruar kur ka zbatuar dispozitën ligjore të cituar më lartë dhe bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi”.

59. Gjykata po ashtu vë në spikamë arsyetimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së lidhur me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës:

“[...] Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për tre paga të papaguara në shumën prej 495.96 euro me vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRZ009-0206 të datës 30 mars 2015 ishte refuzuar si e pavlefshme me arsyetimin se paditësi nuk rezulton të ketë ofruar shërbime për N.SH dhe sepse AL kishte vlerësuar që në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar kërkesa e paditësit ishte parashkruar.

[...]

Kolegji i Apelit i DHPGJS-së vlerëson se Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së nuk është vendim i drejtë. Kjo për faktin se paditësi fillimisht kishte dorëzuar një ankesë në DHPGJS me datë 24 prill 2015 me të cilën kishte ankimuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ009-0206 të datës 30 mars 2015 i cili trajtonte kompensimin për tre paga të papaguara në shumën prej 495.96 euro (3*165.32) dhe jo shumën që ai e kërkonte me ankesë prej 12,267.30 euro për periudhën nga viti 2004 deri në 2013.

[...]

Kolegji i Apelit konsideron se në rastin konkret shkalla e parë e DHPGJS-së duhet të kishte parasysht faktin se paditësi kishte ankimuar vendimin Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ009-0206 të datës 30 mars 2015 për tre paga të papaguara në shumën prej 495.96 euro dhe jo vendimin me nr. PRZ009-0208 të datës 23 prill 2015 si dhe PRZ09-0210 që paditësi nuk i kishte ankimuar, por vetëm bashkëngjitur në shkresë të lëndës në shkallën e parë të DHPGJS-së si dhe pranë Kolegjit të Apelit.

[...]

Gjithashtu, Kolegji i Apelit vëren se nga kopja e librezës së punës shihet qartë që paditësit i është mbyllur librezë e punës me datë 6 shtator 2013, pikërisht me datën e fillimit të procesit të privatizimit N.SH-së, gjë që dëshmon se paditësi jo vetëm që ka ofruar shërbime për N.SH. por edhe marrëdhënia e punës i është ndërprerë si rezultat i veprimit/vendimit të AKP.

Në këtë rast duke u bazuar në provat e lartcekura të cilat janë relevante për Kolegjin e Apelit, Kolegji i Apelit vendosi të ndryshoj Aktgjykimin e shkallës së parë të DHPGJS-së duke aprovuar paditësit kërkesës për kompensimin e tre pagave të papaguara në shumën prej 495.96 euro, e cila duhet të paguhet nga Autoriteti i Likuidimit sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e Likuidimit.

Gjithashtu Kolegji i Apelit aprovon lartësinë e shumës së kërkuar edhe për arsye se e paditura nuk e konteston lartësinë e shumës së kërkuar.

Faktet e pakontestuar sipas nenit 7 të LPK-së konsiderohen të vërtetuara.

Prandaj për këto arsye, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa e paditësit duhet të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar.”

60. Në lidhje me mbajtjen e seancës dëgjimore, Gjykata vëren se të dyja kolegjet e DHPGJS-së, shprehimisht vendosën që të mos mbajnë seancë dëgjimore në këtë çështje bazuar

në paragrafin 3 të nenit 76 Ligjit për DHPGJS për Çështjet në lidhje me AKP-në në lidhje me nenin 399 të LPK-së, respektivisht në paragrafin 1 të nenit 69 të Ligjit për DHPGJS për Çështjet në lidhje me AKP-në.

61. Gjykata rikujton se Autoriteti i Likuidimit të AKP-së refuzoi të tria kërkesat e parashtruesit të kërkesës për (i) kompensimin e 7 (shtatë) pagave të papaguara për periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2013; (ii) kompensimin e 3 (tri) pagave të papaguara për periudhë të pacaktuar dhe (iii) ndërprerjen e kontratës së punës, përmes tri vendimeve të veçanta në vitin 2015. Gjykata vëren se Autoriteti i Likuidimit të AKP-së dy kërkesat e para i refuzoi me arsyetimin se ishin kërkesa që kishin të bëjnë me vitin 2004 dhe për pasojë ishin parashtruar bazuar në nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar të vitit 1976, ndërsa kërkesën e tretë, e refuzoi për shkak se bazuar në shkresat e lëndës rezultoi se ai nuk kishte më në listën e punëtorëve aktiv për periudhën gusht 2012 deri në muajin gusht 2013, kur edhe u mor vendimi për privatizim.
62. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës në kërkesëpadinë e tij kërkoi shprehimisht shfuqizimin e Vendimit [PRX009-02064] të 30 marsit 2015 të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, përmes të cilit ishte refuzuar kërkesa e tij për kompensimin e 3 (tre) pagave të papaguara në vlerën prej 465.96 (katërqind e nëntëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent) për periudhë të pacaktuar.
63. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së ia refuzoi kërkesëpadinë parashtruesit të kërkesës, ndërsa Kolegji i Apelit të DHPGJS-së ia miratoi ankesën, por vetëm sa i përket kërkesës për kompensimin e 3 (tri) pagave të papaguara në vlerën prej 465.96 (katërqind e nëntëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent) për periudhë të pacaktuar, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës në kërkesëpadi “[...] kishte ankimuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ009-0206 të datës 30 mars 2015 i cili trajtonte kompensimin për tre paga të papaguara në shumën prej 495.96 euro (3*165.32) dhe jo shumën që ai e kërkonte me ankesë prej 12,267.30 euro për periudhën nga viti 2004 deri në 2013.”
64. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se procedurat e zhvilluara pranë Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së: (i) nuk ngritin ndonjë çështje të ndërlikueshmërisë së posaçme çka do ta bënte mbajtjen e seancës dëgjimore të domosdoshme, ndër të tjera, për faktin se me Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe ndryshoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së dhe Vendimin [PRZ009-0206] e 30 marsit 2015, të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, duke i akorduar shumën prej 3 (tre) pagave të papaguara; si dhe (ii) nga natyra e rastit rrjedhë se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së, bazuar mbi parashtrësia dhe materialet me shkrim, ka zgjidhur rastin në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme, për shkak se parashtruesi i kërkesës në kërkesëpadinë e tij kishte kërkuar shprehimisht që të shfuqizohet vetëm njëri vendim i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, respektivisht, Vendimin [PRZ009-0206] e 30 marsit 2015.
65. Përkitazi me pretendimin për mos mbajtje të seancës dëgjimore, Gjykata në praktikën gjyqësore të saj ka konstatuar shkelje në rastet kur Kolegji i Apelit të DHPGJS-së ka vlerësuar çështje të faktit dhe të ligjit duke e ndryshuar kështu vendimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së në dëm të parashtruesve të kërkesës (shih rastin e Gjykatës [KI145/19](#), [KI146/19](#), [KI147/19](#), [KI149/19](#), [KI150/19](#), [KI151/19](#), [KI152/19](#), [KI153/19](#), [KI154/19](#), [KI155/19](#), [KI156/19](#), [KI157/19](#) dhe [KI159/19](#), parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 81). Gjykata në jurisprudencën e saj po ashtu ka konstatuar se mos mbajtja e seancës dëgjimore nga Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit të DHPGJS-së nuk bie ndesh me nenin 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, për shkak se rasti karakterizohet nga çështje të “natyrës së lartë teknike” apo “ekskluzivisht ligjore” dhe se i njëjti mund të zgjidhet në

mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme bazuar në parashtruesat dhe materialet tjera të dorëzuara nga palët (shih rastin e Gjykatës [KI160/20](#) parashtrues *Komuna e Gjilanit*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 majit 2022, paragrafët 98-105, [KI80/23](#), parashtrues *Behgjet Stoliqi*, cituar më lart, paragrafi 53, [KI125/23](#), parashtrues *Hazir Biblica*, cituar më lart, paragrafi 53).

66. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret dhe praktikën e saj gjyqësore, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për shkak të mos mbajtjes së seancës dëgjimore, siç garantohen me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, janë të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese në “*mungesë evidente të shkeljes*” ashtu siç është përcaktuar me paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së Punës.
67. Në fund, sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës, se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nuk lëshoi urdhër për rregullimin dhe plotësimin e padisë duke shkelur kështu dispozitat procedurale të Ligjit për DHPGJS për Çështjet në lidhje me AKP-në, Gjykata konsideron se në këtë rast, parashtruesi ngrit pretendime të përgjithësuara, pa saktësuar të drejtat kushtetuese të cilat ai pretendon se i janë cenuar dhe pa qartësuar faktet që arsyetojnë pretendimet konkrete. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore, se për të konsideruar që një kërkesë plotëson kriteret e pranueshmërisë, parashtruesi i kërkesës është i detyruar që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri, të garantuara me Kushtetutë, i janë cenuar dhe në mënyrë adekuate të paraqesë faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih në këtë kontekst rastet e Gjykatës, [KI91/17](#), parashtrues *Enver Islami*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018, paragrafi 31; [KI206/19](#), parashtrues *Mladen Nikolić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 26 shkurtit 2019, paragrafi 33; si dhe shih rastin [KI97/20](#), parashtrues *Nehat Salihu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 marsit 2021, paragrafi 54, [KI73/21](#), parashtruese *Minire Krasniqi Zhitia*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2021, paragrafi 39). Rrjedhimisht, në rastin konkret, Gjykata vlerëson se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është i papranueshëm në kategorinë e pretendimeve të “*pambështetura dhe paarsyetuara*”, ashtu siç parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit, si dhe rregullin 34 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës, më 16 korrik 2024,

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË, me 7 (shtatë) vota për dhe 2 (dy) kundër, kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtar raportues



Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani